# DËSHMI ARKIVI

**A-471172**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Gjenerali" merr zyrtarisht rolin e Ambasadorit të SHBA në Shqipëri, kush ishin 10 paraardhësit e tij - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/gjenerali-merr-zyrtarisht-rolin-e-ambasadorit-te-shba-ne-shqiperi-kush-ishin-10-paraardhesit-e-tij/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 10:46:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 10:43:31 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `50f1c366ff7153ea48e15a259978be0a1366ecce14f8f79993a1b0aead741855` |
| TEKSTI | `c0170b1419239f16bb25615d3b8784b789d9b9e54dfd1691e1715509316d609c` |
| PAMJA | `c2add5f1ab6ae2d73c6082b805e67df02094aca597c5a256b333c7a1a327f00b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `097ddd007f9e914369ea467ab875a02ed2a9fafe98658e2b5e33314b51a187e3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/097ddd007f9e914369ea467ab875a02ed2a9fafe98658e2b5e33314b51a187e3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LAJM KRYESOR | POLITIKË

# “Gjenerali” merr zyrtarisht rolin e Ambasadorit të SHBA në Shqipëri, kush ishin 10 paraardhësit e tij

26 Shtator 2026 | 12:43

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Eric Wendt ka marrë zyrtarisht detyrën si Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, duke rikthyer pas gati tre vitesh një ambasador të konfirmuar në krye të misionit diplomatik amerikan në Tiranë.

Wendt i dorëzoi këtë të shtunë, letrat kredenciale Presidentit Bajram Begaj, duke nisur zyrtarisht mandatin e tij në Shqipëri. Ai pason Yuri Kim, e cila përfundoi detyrën në qershor të vitit 2023.

I propozuar nga Presidenti amerikan Donald Trump dhe i konfirmuar nga Senati më 6 gusht 2026, Wendt vjen në Shqipëri pas një karriere më shumë se 34-vjeçare në ushtrinë amerikane dhe me përvojë në fushën e sigurisë dhe operacioneve speciale.

Por kush kanë qenë diplomatët që kanë drejtuar më parë Ambasadën e SHBA-së në Tiranë?

Sipas të dhënave zyrtare të Departamentit të Shtetit, dhjetë ambasadorët e fundit përpara Eric Wendt janë:

**1. Yuri Kim** -Ambasadore e SHBA-së në Shqipëri nga janari 2020 deri në vitin 2023. Ajo ishte ambasadorja e fundit përpara Wendt dhe pas largimit të saj posti mbeti për një periudhë të gjatë pa një ambasador të konfirmuar.

**2. Donald Lu** -Ambasador nga janari 2015 deri në shtator 2018. Gjatë mandatit të tij, marrëdhëniet SHBA-Shqipëri u përqendruan veçanërisht te reforma në drejtësi dhe lufta kundër korrupsionit.

**3. Alexander A. Arvizu** -Ambasador nga dhjetori 2010 deri në janar 2015.

**4. John L. Withers** – Ambasador nga gushti 2007 deri në gusht 2010.

**5. Marcie B. Ries** -Ambasadoreshë nga tetori 2004 deri në qershor 2007.

**6. James F. Jeffrey** – Ambasador nga tetori 2002 deri në maj 2004.

**7. Joseph A. Limprecht** -Ambasador nga shtatori 1999 deri në maj 2002.

**8. Marisa R. Lino** -Ambasadoreshë nga shtatori 1996 deri në maj 1999.

**9. Joseph E. Lake** -Ambasador nga tetori 1994 deri në mars 1996.

**10. William E. Ryerson** – Ambasadori i parë amerikan në Shqipërinë e pas-rivendosjes së

LAJMI I FUNDIT

12:42 **Presidentja e Venezuelës kthehet nga vizita në SHBA pa marrëveshje dhe pa datë për zgjedhjet**

12:34 **Mori zyrtarisht detyrën, kush është ambasadori i ri i SHBA në Shqipëri, Eric Wendt?**

12:24 **Pas më shumë se një ore, përfundon takimi i ambasadorit Wendt me presidentin Begaj (VIDEO)**

12:19 **Moti ndryshon në Shqipëri, meterologia: Mëngjeset mbetet të freskëta, temperaturat do rriten**

12:15 **Të shtëna me armë në aksin Prishtinë-Ferizaj, tre të plagosur**

12:06 **Italia në “krizë” edhe pas rikthimit të Mancinit, humb 2-0 në shtëpi kundër Belgjikës**

TESTIM

**10. William E. Ryerson** – Ambasadori i parë amerikan në Shqipërinë e pas-rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike, me mandat nga dhjetori 1991 deri në tetor 1994.

Marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara u rivendosën më 15 mars 1991, ndërsa Ambasada amerikane në Tiranë u hap më 1 tetor të po atij viti. Përpara emërimit të Ryerson, Christopher Hill shërbeu për një periudhë të shkurtër si *chargé d'affaires* nga tetori deri në dhjetor 1991, por ai nuk ishte ambasador.

Me Eric Wendt në krye të misionit diplomatik, SHBA-të rikthejnë kështu një ambasador të konfirmuar në Tiranë pas më shumë se tre vitesh. Wendt ka deklaruar gjatë seancës së konfirmimit në Senat se ndër prioritetet e tij në Shqipëri do të jenë sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe forcimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

---

**Shiko në:**


## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI | VIDEO

### Pas më shumë se një ore, përfundon takimi i ambasadorit Wendt me presidentin Begaj (VIDEO)

Ka përfunduar prej një orë e 25 minuta,, takimi i ambasadorit të ri të SHBA, Eric Wendt me presidentin Bajram Begaj. Gjatë takimit, ambasadori i...

12:24 | 26/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI

### Operacion blic i SPAK, arrestohet një person me rrezikshmëri të lartë! Shpallet në kërkim një tjetër (EMRAT)

SPAK ka zhvilluar këtë të shtunë një operacion blic në qytetin e Shkodrës ku mësohet se është vënë në pranga një 50-vjeçar me rrezikshmëri të...

10:37 | 26/09/2026

LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

### Dosja e 'SHISH', Bashkimi Europian: Kemi besim të plotë te SPAK

Bashkimi Europian ka përcjellë një mesazh të qartë nga Brukseli për drejtësinë shqiptare, duke shprehur besim dhe mbështetje për SPAK në hetimin dhe ndjekjen penale...

10:30 | 26/09/2026





Copyright © Euronews 2026


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.